

Ky është një përkthim zyrtar.

DIREKTIVA 95/46

E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE KËSHILLIT

e 24 tetorit 1995

PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME

PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE SI

EDHE LËVIZJEN E LIRË TË KËTYRE TË DHËNAVE

(Gazeta Zyrtare L 281, 23.11.1995, fq. 31)

Amenduar nga:

**Rregullorja (KE) Nr 1882/2003 e Parlamentit European
dhe e Këshillit e 29 shtatorit 2003**

Gazeta Zyrtare		
Nr.	Faqe	Datë
L284	1	31.10.2003

DIREKTIVA 95/46 E PARLAMENTIT EUROPIAN DHE KËSHILLIT

e 24 tetorit 1995

**për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale si edhe
lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave**

PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit European e sidomos Nenin 100 a të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit¹,

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social²,

Duke vepruar në përputhje me procedurën e përmendur në Nenin 189 b të Traktatit³,

1. Duke qenë se objektivat e Komunitetit, të shpallura në Traktat, ashtu siç është ndryshuar nga Traktati i Bashkimit European, konsistojnë në krijimin e një bashkimi gjithnjë e më të ngushtë mes popujve të Europës, nxitjen e marrëdhënieve më të ngushta ndërmjet Shteteve që janë pjesë e Komunitetit, duke siguruar një përparim ekonomik dhe shoqëror me anë të veprimeve të përbashkëta me qëllim eliminimin e barrierave që ndajnë Europën, duke nxitur përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës së popujve të tij, duke ruajtur dhe forcuar paqen dhe lirinë dhe duke nxitur demokracinë mbi bazën e të drejtave themelore të njohura me kushtetutë dhe legjislacionet e Shteteve Anëtare dhe në Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut;
2. Duke qenë se sistemet për përpunimin e të dhënave janë në shërbim të njeriut, se ato, pavarësisht nga kombësia apo vendbanimi i individëve duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë e tyre themelore, sidomos të drejtën e jetës private, dhe të

¹ Gazeta Zyrtare Nr. C 277, 5. 11. 1990, fq. 3 dhe Gazeta Zyrtare Nr C 311, 27. 11. 1992, fq. 30.

² Gazeta Zyrtare Nr C 159, 17. 6. 1991, fq 38.

³ Opinion I Parlamentit European i 11 marsit 1992 (Gazeta Zyrtare Nr C 94, 13. 4. 1992, fq. 198), konfirmuar në 2 dhjetor 1993 (Gazeta Zyrtare Nr C 342, 20. 12. 1993, fq. 30); Qëndrim i përbashkët i Këshillit i 20 shkurtit 1995 (Gazeta Zyrtare Nr C 93, 13. 4. 1995, fq. 1) dhe Vendimi I Parlamentit European i 15 qershorit 1995 (Gazeta Zyrtare Nr C 166, 3. 7. 1995).

kontribuojnë për zhvillimin ekonomik dhe përparimin shoqëror, zgjerimin e tregtisë dhe mirëqenien e individëve;

3. Duke qenë se themelimi dhe funksionimi i një tregu të brendshëm në të cilin sipas Nenit 7/a të Traktatit sigurohet lëvizja e lirë e mallrave, njerëzve, shërbimeve dhe kapitalit, kërkojnë jo vetëm lëvizjen e lirë të të dhënave personale nga njëri Shtet Anëtar tek tjetri, por gjithashtu edhe mbrojtjen e të drejtave themelore të individëve;
4. Duke qenë se në Komunitet, po përdoret gjithnjë e më shpesh përpunimi i të dhënave personale në fusha të ndryshme të veprimtarisë ekonomike dhe shoqërore; se përparimi i shënuar nga teknologjia e informacionit po e bën përpunimin dhe shkëmbimin e këtyre të dhënave shumë më të thjeshtë;
5. Duke qenë se integrimi ekonomik dhe social që vjen si pasojë e themelimit dhe funksionimit të tregut të brendshëm sipas kuptimit të Nenit 7/a të Traktatit do të çojë rrjedhimisht në një rritje të konsiderueshme të qarkullimit ndërkufitar të të dhënave personale ndërmjet të gjithë subjekteve të jetës ekonomike dhe sociale të Shteteve Anëtare, qofshin këta privatë apo publikë; se administratat kombëtare në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të bashkëpunojnë për zbatimin e të drejtës komunitare, dhe të shkëmbejnë të dhëna personale në mënyrë që të mund të ushtrojnë funksionet e veta dhe të kryejnë detyrat në emër të një administrate në një shtet tjetër Anëtar brenda hapësirës pa kufij të brendshëm që është themeluar nga tregu i brendshëm;
6. Duke qenë se, për më tepër, forcimi i bashkëpunimit shkencor dhe teknik si edhe futja në punë e rrjeteve të reja dhe të bashkërenduara të telekomunikacionit në Komunitet, kërkon dhe lehtëson qarkullimin ndërkufitar të të dhënave personale;
7. Duke qenë se, nivelet e ndryshme të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sidomos të jetës private, që janë të garantuara në Shtetet Anëtare lidhur me përpunimin e të dhënave personale mund të pengojnë transmetimin e këtyre të dhënave nga territori i një Shteti Anëtar në atë të një Shteti tjetër dhe se ky dallim në nivelet e mbrojtjes mund të përbëjë një pengesë për ushtrimin e një sërë veprimtarish ekonomike në nivel komunitar, të shtrembërojë konkurrencën dhe t'i pengojë administratat në kryerjen e detyrave që ato kanë sipas të drejtës komunitare; se këto nivele të ndryshme mbrojtjeje ekzistojnë për shkak të një sërë dispozitash ligjore, rregulloresh dhe dispozitash administrative;
8. Duke qenë se, për të eliminuar pengesat për qarkullimin e të dhënave personale, niveli i mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut në lidhje me përpunimin e këtyre të dhënave, duhet të jetë ekuivalent në të gjithë Shtetet Anëtare; se një objektiv i

tillë, thelbësor për tregun e brendshëm, nuk mund të arrihet vetëm nëpërmjet veprimeve të Shteteve Anëtare, sidomos duke mbajtur parasysh shkallën e madhe të divergjencave që ekzistojnë ndërmjet ligjeve përkatëse në çdo Shtet Anëtar dhe nevojës për t'i bashkërenduar ato, me qëllim që qarkullimi ndërkufitar i të dhënave personale të disiplinohet në një mënyrë të njëtrajtshme dhe në përputhje me objektivin e tregut të brendshëm, sipas kuptimit të Nenit 7/a të Traktatit; se ndërhyrja e Komunitetit rezulton e nevojshme me qëllim përafrimin e legjislacioneve;

9. Duke qenë se, pasja e një mbrojtjeje ekuivalente që rrjedh prej përafrimit të legjislacioneve kombëtare, bën që Shtetet Anëtare mund të mos e pengojnë dot më qarkullimin e lirë mes tyre të të dhënave personale duke u bazuar në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, dhe sidomos tek e drejta për jetën private; se Shteteve Anëtare do t'u mbetet në dorë hapësirë manovrimi, që mund ta përdorin, në kuadër të zbatimit të Direktivës, partnerët ekonomikë dhe socialë; se për pasojë, Shtetet Anëtare do të mund të specifikojnë në të drejtën e brendshme kushtet e përgjithshme dhe legjitimitetin e përpunimit të të dhënave; se për pasojë, Shtetet Anëtare do të përpiqen që të përmirësojnë mbrojtjen që parashikohet aktualisht në legjislacionin e tyre; se brenda kufizimeve të kësaj hapësire manovrimi dhe në përputhje me të drejtën komunitare, mund të verifikohen mospërputhje në zbatimin e Direktivës, dhe kjo mund të ndikojë në lëvizjen e të dhënave brenda një Shteti Anëtar por edhe brenda Komunitetit;
10. Duke qenë se objekti i ligjeve të brendshme për përpunimin e të dhënave personale është që të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore, sidomos të drejtën e jetës private, që njihet si nga Neni 8 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ashtu edhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës Komunitare; se për këtë arsye, përafrimi i këtyre ligjeve nuk duhet të ketë si efekt dobësimin e mbrojtjes që ato sigurojnë por përkundrazi, duhet të synojë një nivel më të lartë mbrojtjeje në Komunitet;
11. Duke qenë se parimet për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve, por sidomos respekti për të drejtën e jetës private, që përmbahen në këtë Direktivë, saktësojnë dhe zgjerojnë parimet që përmbahen në Konventën e Këshillit të Europës të 28 janarit 1981 për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale;
12. Duke qenë se parimet e mbrojtjes duhet të gjejnë zbatim tek të gjithë përpunimet e të dhënave personale nga çdo person veprimtaritë e të cilit rregullohen nga e drejta

komunitare; se duhet të përjashtohet përpunimi i të dhënave personale që kryhet nga një person fizik gjatë ushtrimit të veprimtarive që janë me karakter krejtësisht personal apo shtëpiak si korrespondenca apo mbajtja e listave me adresa;

13. Duke qenë se veprimtaritë që parashikohen nga Kapitujt V dhe VI të Traktatit të Bashkimit Europian në lidhje me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë e Shtetit apo veprimtaritë e Shtetit në fushën e të drejtës penale, nuk hyjnë në fushën e zbatimit të së drejtës komunitare dhe nuk çënojnë detyrimet e Shteteve Anëtare sipas Nenit 56 (2), Nenit 57 ose Nenit 100/a të Traktatit themelues të Komunitetit Europian; se përpunimi i të dhënave personale që është i nevojshëm për mbrojtjen e mirëqenies ekonomike të Shtetit, nuk hyn në fushën e zbatimit të kësaj direktive, në rastet kur një përpunim i tillë lidhet me çështje të sigurisë së Shtetit;
14. Duke qenë se, me rëndësinë e zhvillimeve aktuale në kuadrin e shoqërisë së informacionit, të teknikave që përdoren për të kapur, transmetuar, manipuluar, regjistruar, ruajtur apo komunikuar të dhënat në formë tingulli apo imazhesh që lidhen me të gjithë personat fizikë, kjo Direktivë duhet të gjejë zbatim për të gjithë përpunimet e të dhënave në format e mësipërme;
15. Duke qenë se përpunimi i të dhënave të sipërpërmendura mbulohet nga kjo Direktivë vetëm nëse ato janë automatike apo kur kemi të bëjmë me të dhëna që mbahen apo janë të destinuara për t'u mbajtur në një arkiv të strukturuar sipas kriterëve specifike që lidhen me individët, në mënyrë që të lejohet një përdorim i thjeshtë i të dhënave personale në fjalë;
16. Duke qenë se në fushën e zbatimit të kësaj direktive nuk hyn përpunimi i të dhënave në formë zanore dhe imazhesh si për shembull në rastet e mbikëqyrjes me kamera, në rast se ai kryhet për qëllime të sigurisë publike, mbrojtjes, sigurisë kombëtare apo gjatë ushtrimit të veprimtarive shtetërore që lidhen me të drejtën penale apo veprimtarive të tjera që nuk janë brenda fushës së zbatimit të së drejtës komunitare;
17. Duke qenë se, për sa i takon përpunimit të të dhënave zanore dhe imazheve për qëllime gazetarie apo qëllime të shprehjes letrare apo artistike, sidomos në fushën audiovizive, parimet e Direktivës gjejnë zbatim në mënyrë të kufizuar sipas dispozitave të përcaktuara në Nenin 9;
18. Duke qenë se, për t'u siguruar që individëve nuk do t'u hiqet mbrojtja të cilën duhet ta gëzojnë sipas kësaj Direktive, çdo përpunim i të dhënave personale në Komunitet duhet të kryhet në përputhje me të drejtën e brendshme të një prej Shteteve Anëtare; se, në lidhje me këtë, përpunimi i të dhënave që kryhet nën përgjegjësinë e

një kontrolluesi të vendosur në një shtet Anëtar duhet të rregullohet nga e drejta e atij Shteti;

19. Duke qenë se vendosja në territorin e një Shteti Anëtar nënkupton ushtrimin e vërtetë dhe real të veprimtarisë nëpërmjet një marrëveshjeje të qëndrueshme; se, forma juridike e një marrëveshjeje të tillë, qoftë kur bëhet fjalë thjeshtë për një degë apo edhe filial me personalitet juridik, nuk është faktori përcaktues në lidhje me këtë; se, kur një kontrollues i vetëm është vendosur në territorin e Shteteve të ndryshme Anëtare, sidomos nëpërmjet filialeve, ai duhet të sigurohet se, me qëllim mosshmangien e këtyre rregullave kombëtare, secili prej këtyre filialeve i përmbush detyrimet e parashikuara nga e drejta kombëtare në lidhje me veprimtarinë që kryen çdo filial;
20. Duke qenë se mbrojtja e individëve që parashikohet nga kjo Direktivë nuk duhet të pengohet nga fakti që përpunimi i të dhënave mund të kryhet nga një person që është vendosur në një vend të tretë; se, në një rast të tillë, përpunimi duhet të bëhet në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar në të cilin janë vendosur mjetet e përdorura, dhe duhet të ketë garanci, për t'u siguruar se të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kjo Direktivë, respektohen në praktikë;
21. Duke qenë se kjo Direktivë nuk çënon rregullat territoriale që gjejnë zbatim në çështjet penale;
22. Duke qenë se, Shtetet Anëtare do të përkufizojnë më saktësisht në ligjet që do të miratojnë apo kur të zbatojnë masat e marra sipas kësaj Direktive, rrethanat e përgjithshme në të cilat përpunimi është i ligjshëm; se sidomos Neni 5 së bashku me Nenet 7 dhe 8, i lejojnë Shtetet Anëtare, pavarësisht nga rregullat e përgjithshme, që të parashikojnë me anë të dispozitave kushte më specifike të përpunimit për sektorë specifikë dhe kategori të ndryshme të dhënash të parashikuara nga Neni 8;
23. Duke qenë se Shtetet Anëtare janë të autorizuar të sigurojnë zbatimin e mbrojtjes së individëve si nëpërmjet një ligji të përgjithshëm për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale ashtu edhe nëpërmjet ligjeve sektoriale, si ato që lidhen për shembull, me institutet e statistikës;
24. Duke qenë se kjo Direktivë nuk çënon dispozitat ligjore për mbrojtjen e personave juridikë lidhur me përpunimin e të dhënave të tyre;
25. Duke qenë se, parimet e mbrojtjes shprehen nga njëra anë, tek detyrimet e ndryshme që vendosen ndaj personave, autoriteteve publike, ndërmarrjeve, agjencive apo organeve të tjera që janë përgjegjëse për përpunimin dhe sidomos për

cilësinë e të dhënave, sigurinë teknike, njoftimin e autoritetit mbikëqyrës, dhe rrethanat sipas të cilave mund të kryhet përpunimi, dhe, nga ana tjetër, tek e drejta që u jepet individëve, të dhënat e të cilëve po përpunohen, që të informohen se përpunimi është duke u kryer, që të aksesojnë të dhënat, të kërkojnë kryerjen e korigjimeve e madje edhe ta kundërshtojnë përpunimin në rrethana të caktuara;

26. Duke qenë se parimet e mbrojtjes duhet të gjejnë zbatim tek çdo informacion që lidhet me një person të identifikuar apo të identifikueshëm; se për të përcaktuar nëse një person është i identifikueshëm, duhet të merret parasysh tërësia e mjeteve që mund të përdoren brenda arsyes ose nga kontrolluesi ose nga ndonjë person tjetër për ta identifikuar personin në fjalë; se parimi i mbrojtjes nuk gjen zbatim tek të dhënat që anonimizohen në një mënyrë të tillë që subjekti i të dhënave nuk mund të identifikohet më; se kodet e etikës sipas kuptimit të Nenit 27 mund të jenë instrumente të dobishme orientimi mbi mënyrat me të cilat të dhënat mund të anonimizohen dhe të mbahen në një formë në të cilën identifikimi i subjektit të të dhënave nuk është më i mundur të kryhet;

27. Duke qenë se mbrojtja e individëve duhet të zbatohet si për përpunimin automatik të të dhënave ashtu edhe për përpunimin manual, se fusha e kësaj mbrojtjeje nuk duhet në fakt që të varet nga teknikat e përdorura, sepse përndryshe kjo do të krijonte një rrezik të madh të shmangies nga dispozitat; se pavarësisht, në lidhje me përpunimin manual, kjo Direktivë gjen zbatim vetëm për arkivat dhe jo për dosje të pastrukturuara; se sidomos, përmbajtja e një arkive duhet të jetë e strukturuar sipas kriterëve specifike që lidhen me individët dhe që lejojnë akses të thjeshtë tek të dhënat personale; se në përputhje me përkufizimin në Nenin 2 (c), kriteret e ndryshme që përcaktojnë elementët përbërës të një tërësie të strukturuar të të dhënave personale, si edhe kriteret e ndryshme në bazë të të cilave kjo tërësi të dhënash mund të aksesohet, mund të saktësohen nga secili Shtet Anëtar; se dosjet ose grupet e dosjeve përfshirë kapakët e tyre, që nuk janë të strukturuar sipas kriterëve specifike, nuk hyjnë në asnjë rast brenda fushës së zbatimit të kësaj Direktive;

28. Duke qenë se çdo përpunim i të dhënave personale duhet të jetë i ligjshëm dhe i drejtë për personat e interesuar; se ai duhet që të ketë sidomos të dhëna të mjaftueshme, jo të tepërta dhe që të lidhen me qëllimin e përpunimit; se këto qëllime duhet të jenë të qarta dhe të ligjshme dhe duhet të përcaktohen në momentin e

mbledhjes së të dhënave; se qëllimet e përpunimit pas mbledhjes së të dhënave nuk mund të kenë mospërputhje me qëllimet e specifikuar fillimisht;

29. Duke qenë se përpunimi i mëtejshëm i të dhënave personale për qëllime historike, statistikore ose shkencore, përgjithësisht nuk konsiderohet se bie në kundërshtim me qëllimet për të cilat të dhënat janë mbledhur më parë, në rast se Shtetet Anëtare japin garanci të mjaftueshme; se këto garanci duhet mbi të gjitha që të mos lejojnë përdorimin e të dhënave në mbështetje të masave apo vendimeve që kanë lidhje me ndonjë individ të veçantë;
30. Duke qenë se, për të qenë i ligjshëm, përpunimi i të dhënave personale duhet që të kryhet edhe me pëlqimin e subjektit të të dhënave ose të jetë i nevojshëm për lidhjen apo zbatimin e një kontrate detyruese për subjektin e të dhënave, apo si një kërkesë e ligjshme, apo për përmbushjen e një detyre me interes publik apo për ushtrimin e autoritetit publik, ose kur kjo është në interesin e ligjshëm të një personi fizik apo juridik, me kusht që këto interesa apo të drejta e liri të subjektit të të dhënave të mos kenë epërsinë; se, sidomos për të garantuar drejtpeshimin e interesave në fjalë duke siguruar një konkurrencë të efektshme, Shtetet Anëtare mund të saktësojnë kushtet sipas të cilave të dhënat personale mund të përdoren apo t'i jepen palëve të treta në kuadër të veprimtarive të ligjshme tregtare të shoqërive apo organeve të tjera; se Shtetet Anëtare mund të thjeshtëzojnë kushtet në të cilat të dhënat personale mund t'u përhapen palëve të treta për qëllime marketingu qoftë kur bëhet fjalë për dërgimin e materialeve reklamuese, po ashtu edhe për dërgimin e materialeve që dërgohen nga ndonjë shoqatë bamirësie apo nga ndonjë shoqëri apo fondacion me natyrë politike për shembull, objekt i dispozitave që e lejojnë një subjekt të dhënash që të kundërshtojë përpunimin e të dhënave që mbahen për të, pa kosto dhe pa e shprehur arsyen.
31. Duke qenë se përpunimi i të dhënave personale duhet po njësoj të konsiderohet i ligjshëm kur ai kryhet për të mbrojtur një interes që është thelbësor për jetën e subjektit të të dhënave;
32. Duke qenë se i takon legjislacionit të brendshëm që të përcaktojë nëse kontrolluesi që përmbush një detyrë me interes publik apo që ushtron një kompetencë zyrtare duhet të jetë një administratë publike apo ndonjë tjetër subjekt i së drejtës publike apo private, si për shembull ndonjë sindikatë;
33. Duke qenë se të dhënat që për shkak të natyrës së tyre mund të dhunojnë liritë themelore ose jetën private nuk duhet të përpunohen në rast se subjekti i të dhënave

nuk jep shprehimisht pëlqimin; se, pavarësisht, derogimet nga ky ndalim duhet të parashikohen shprehimisht në rastet e nevojave specifike, sidomos kur përpunimi i këtyre të dhënave kryhet për qëllime shëndetësore nga persona që janë subjekt i detyrimit ligjor të ruajtjes së sekretit profesional apo gjatë kryerjes së veprimtarive të ligjshme të shoqërive apo fondacioneve qëllimi i të cilave konsiston në lejimin e ushtrimit të lirive themelore;

34. Duke qenë se duhet që edhe shtetet Anëtare të autorizohen, kur kjo justifikohet nga motive me interes publik, që të derogojnë nga ndalimi i përpunimit të kategorive sensitive të të dhënave kur kjo justifikohet nga arsye të rëndësishme me interes publik, si për shembull shëndeti publik dhe mbrojtja sociale – sidomos në mënyrë që të garantohet cilësia dhe efikasiteti i kostos së procedurave të përdorura për t'iu përgjigjur kërkesave për shërbime në sistemin e sigurimeve shëndetësore, kërkimeve shkencore si edhe statistikave publike; se u takon atyre që të japin garanci specifike dhe të përshtatshme për të mbrojtur të drejtat themelore dhe jetën private të individëve;
35. Duke qenë se akoma më tej, përpunimi i të dhënave personale nga autoritetet publike për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në të drejtën kushtetuese apo në të drejtën publike ndërkombëtare, nga shoqata fetare të njohura kryhet për motive të rëndësishme të interesit publik;
36. Duke qenë se, gjatë veprimtarive që lidhen me zgjedhjet, funksionimi i sistemit demokratik në disa Shtete Anëtare kërkon nga ana e partive politike mbledhjen e të dhënave mbi bindjet politike të njerëzve, përpunimi i këtyre të dhënave mund të lejohet për motive të një interesi të rëndësishëm publik, me kusht që të përmbushen garancitë e duhura;
37. Duke qenë se përpunimi i të dhënave personale për qëllime gazetarie ose për qëllime të shprehjes letrare ose artistike, sidomos në fushën audiovizive, duhet të përfitojë përjashtimin nga kërkesat e disa dispozitave të Direktivës, për aq sa kjo është e nevojshme për të bashkërenduar të drejtat themelore të individëve me lirinë e informacionit dhe sidomos të drejtën për të marrë dhe përcjellë informacion, ashtu siç garantohet sidomos nga Neni 10 i Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut; se për këtë arsye, Shtetet Anëtare duhet të përcaktojnë përjashtimet dhe derogimet e nevojshme me qëllim gjetjen e një ekuilibri ndërmjet të drejtave themelore për sa u takon masave të përgjithshme për ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave, masat për transferimin e të dhënave në

vende të treta dhe kompetencat e autoritetit mbikëqyrës; se kjo nuk duhet, gjithësesi, që t'i çojë Shtetet Anëtare në përcaktimin e përjashtimeve për masat e garancisë për sigurinë e përpunimit; se autoritetit mbikëqyrës përgjegjës për këtë sektor duhet që t'i jepet të paktën kompetenca a posteriori, për shembull, që të botojë një raport periodik apo që t'ia kalojë çështjet autoriteteve gjyqësore;

38. Duke qenë se, përpunimi i drejtë i të dhënave nënkupton se subjekti i të dhënave mund të jetë në dijeni të përpunimit dhe, kur të të dhënat mblidhen prej tij, duhet t'i jepet një informacion i saktë dhe i plotë, duke mbajtur parasysh rrethanat e mbledhjes.
39. Duke qenë se disa përpunime bëhen me të dhëna të cilat kontrolluesi i ka mbledhur drejtpërdrejt prej subjektit të të dhënave; se, akoma më tej, të dhënat mund t'i përhapen në mënyrë të ligjshme një pale të tretë, edhe pse kjo përhapje nuk ishte parashikuar në kohën kur të dhënat u mblodhën nga subjekti i të dhënave; se, në të gjitha rastet, subjekti i të dhënave duhet të informohet në momentin e regjistrimit të të dhënave ose maksimumi kur këto të dhëna i përhapen për herë të parë një pale të tretë;
40. Duke qenë se, sidoqoftë, nuk është e nevojshme që të vendoset një detyrim i tillë kur subjekti i të dhënave është informuar më parë; se, veç kësaj, nuk do të vendoset një detyrim i tillë nëse regjistrimi ose përhapja janë përcaktuar shprehimisht me ligj, ose nëse informimi i subjektit të të dhënave rezulton i pamundur ose nënkupton përpjekje të tepërta, siç mund të jetë rasti i përpunimeve për qëllime historike, statistikore ose shkencore; se në lidhur me këtë, numri i subjekteve të të dhënave, mosha e të dhënave dhe masat kompensuese mund të merren në konsideratë;
41. Duke qenë se çdo person duhet të ketë mundësi të ushtrojë të drejtën e aksesit tek të dhënat e tij që janë duke u përpunuar, në mënyrë që të verifikojë sidomos saktësinë e të dhënave dhe ligjshmërinë e përpunimit; se, për të njëjtat arsye, çdo subjekt i të dhënave duhet të ketë të drejtën që të njohë logjikën e përfshirë në përpunimin automatik të të dhënave që mbahen për të, të paktën në rastin e vendimeve automatike që përmenden në Nenin 15 (1); se, kjo e drejtë nuk duhet të çenojë sekretet tregtare apo pronësinë intelektuale dhe sidomos të drejtat e autorit që mbrojnë programin kompjuterik; se kjo, nuk duhet të përkthehet në refuzimin për t'i dhënë informacion subjektit të të dhënave;
42. Duke qenë se Shtetet Anëtare munden, në interesin e subjektit të të dhënave ose për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e të tjerëve, të kufizojnë të drejtat e aksesit dhe të

informimit; se munden, për shembull që të specifikojnë se aksesit tek të dhënat mjekësore mund të merret vetëm nëpërmjet personelit të shëndetësisë;

43. Duke qenë se kufizimet mbi të drejtën e aksesit dhe të informimit si edhe mbi disa detyrime të kontrolluesit mund të vendosen nga Shtetet Anëtare deri në atë masë në të cilën këto kufizime janë të nevojshme për të mbrojtur për shembull, sigurinë kombëtare, mbrojtjen, sigurinë publike apo interesa të rëndësishëm ekonomikë ose financiarë të një Shteti Anëtar apo të Bashkimit, si edhe të hetimeve dhe ndjekjeve penale apo në rastet e shkeljes së etikës të profesioneve të rregulluara, se lista e përjashtimeve dhe kufizimeve duhet të përfshijë detyrat e monitorimit, hetimit apo të rregullimit të nevojshëm në tre sektorët e fundit e që kanë lidhje me sigurinë publike, interesat ekonomikë ose financiarë dhe parandalimin e krimit; se renditja e detyrave të këtyre tre sektorëve nuk cënon legjitimitetin e përjashtimeve dhe të kufizimeve të justifikuara nga arsye të sigurisë së Shtetit apo të mbrojtjes;
44. Duke qenë se Shtetet Anëtare mund të detyrohen për shkak të dispozitave të së drejtës komunitare që të derogojnë nga dispozitat e kësaj Direktive në lidhje me të drejtën e aksesit, detyrimin për t'i informuar individët dhe cilësinë e të dhënave, në mënyrë që të mbrojnë disa prej qëllimeve të përmendura më sipër;
45. Duke qenë se, në rastet kur të dhënat mund të përpunohen në mënyrë të ligjshme mbi bazën e interesit publik, ushtrimin të autoritetit publik apo të interesit legjitim të një individi apo personi juridik, çdo subjekt i të dhënave duhet që gjithësesi të ketë të drejtën, mbi baza legjitime dhe detyruese që lidhen me situatën e tij të veçantë, që të kundërshtojë përpunimin e të dhënave që lidhen me të; se Shtetet Anëtare mundet që pavarësisht nga kjo të parashikojnë dispozita kombëtare të kundërta;
46. Duke qenë se mbrojtja e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale kërkon marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative, si në momentin e projektimit ashtu edhe gjatë vetë përpunimit, sidomos për të ruajtur sigurinë dhe rrjedhimisht, për parandalimin e përpunimit të paautorizuar; duke qenë se u takon Shteteve Anëtare që të sigurohen se kontrolluesit i zbatojnë këto masa; se këto masa duhet të sigurojnë një nivel të mjaftueshëm sigurie, duke marrë në konsideratë njohuritë teknike dhe kostot e zbatimit në lidhje me rreziqet që paraqet përpunimi dhe natyra e të dhënave që duhet të mbrohen;
47. Duke qenë se një mesazh që përmban të dhëna personale transmetohet me anë një shërbimi telekomunikacioni apo postës elektronike, me qëllimin e vetëm

transmetimin e mesazheve të tilla, kontrollues i të dhënave që përmbahet në mesazh do të konsiderohet personi nga i cili buron mesazhi dhe jo personi që ofron shërbimet e transmetimit; se megjithatë, ata që ofrojnë shërbime të tilla konsiderohen zakonisht kontrollues për sa i takon përpunimit të të dhënave personale shtesë, të cilat janë të nevojshme për funksionimin e shërbimit;

48. Duke qenë se njoftimi pranë autoritetit mbikëqyrës ka për qëllim bërjen publike të qëllimit të përpunimit dhe të karakteristikave kryesore të çdo përpunimi, me qëllim verifikimin se ky përpunim është në përputhje me normat kombëtare të hartuara sipas kësaj Direktive;
49. Duke qenë se, në mënyrë që të shmangen formalitetet e panevojshme administrative, përjashtimet nga detyrimi për njoftim dhe thjeshtimi i njoftimit të detyrueshëm mund të parashikohen nga Shtetet Anëtare në ato raste kur përpunimi nuk ka gjasa që të cënojë të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, me kushtin që kjo të jetë në përputhje me aktin e miratuar nga Shteti Anëtar në të cilin specifikohen kufizimet; duke qenë se Shtetet Anëtare mundet që po ashtu, të parashikojnë përjashtime apo thjeshtime në rastet kur një person i ngarkuar nga kontrolluesi sigurohen se përpunimi i kryer nuk ka gjasa që të cënojë të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave; se një oficer i mbrojtjes së të dhënave personale, i punësuar apo jo nga kontrolluesi, duhet të ketë pozita të tilla që të mund të ushtrojë funksionin e tij në pavarësi të plotë;
50. Duke qenë se përjashtimet apo thjeshtimet mund të parashikohen për ato përpunime qëllimi i vetëm i të cilave është mbajtja e një regjistri që sipas të drejtës së brendshme ka për qëllim dhënien e informacionit për publikun dhe që është i hapur për konsultim nga publiku apo cildo që tregon një interes legjitim;
51. Duke qenë se, pavarësisht nga thjeshtimi apo përjashtimi nga detyrimi për të njoftuar, kontrolluesi nuk është i çliruar nga detyrimet e tjera që rrjedhin nga kjo Direktivë;
52. Duke qenë se, në këtë kontekst, kontrolli a posteriori nga ana e autoriteteve kompetente duhet të konsiderohet një masë e mjaftueshme;
53. Duke qenë se, pavarësisht se disa lloje përpunimi mund të paraqesin rreziqe specifike për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave për shkak të natyrës, fushës apo qëllimit që ato kanë, si për shembull përjashtimi i individëve nga një e drejtë, një përfitim apo një kontratë ose me anë të përdorimit specifik të një

teknologjie të re; se u takon Shteteve Anëtare të vendosin nëse dëshirojnë, që t'i specifikojnë këto rreziqe në të drejtën e brendshme;

54. Duke qenë se lidhur me të gjithë përpunimin që kryhet në shoqëri, numri i përpunimeve që paraqet rreziqe të tilla duhet të jetë shumë i kufizuar; se Shtetet Anëtare duhet të parashikojnë se autoriteti mbikëqyrës, ose oficeri për mbrojtjen e të dhënave në bashkëpunim me autoritetin, kontrollon një përpunim të tillë përpara se ai të kryhet; se pas këtij kontrolli paraprak, autoriteti mbikëqyrës mundet, sipas legjislacionit të tij të brendshëm, të japë një opinion ose një autorizim në lidhje me përpunimin; se një kontroll i tillë mund të kryhet gjithashtu gjatë hartimit të një dispozite nga Parlamenti kombëtar ose të një dispozite që parashikohet në një masë të tillë ligjore, që përcakton natyrën e përpunimit dhe përcakton garancitë e përshtatshme;
55. Duke qenë se në rast se kontrolluesi nuk i respekton të drejtat e subjekteve të të dhënave, legjislacioni i brendshëm duhet të japë një zgjidhje juridike; se çdo dëmtim që i shkaktohet dikujt si pasojë e përpunimit të paligjshëm duhet të dëmshpërblehet nga kontrolluesi, i cili mund të përjashtohet nga përgjegjësia e vet nëse provon se nuk ishte përgjegjës për dëmin, sidomos në ato raste kur ai vë në dukje ekzistencën e një gabimi nga ana e subjektit të të dhënave ose në rast të forcave madhore; se sanksionet duhet të zbatohen për çdo subjekt të së drejtës private apo asaj publike që nuk i zbaton dispozitat kombëtare për zbatimin e kësaj Direktive;
56. Duke qenë se, qarkullimi ndërkufitar i të dhënave personale është i nevojshëm për zgjerimin e tregtisë ndërkombëtare; se mbrojtja e individëve e cila është e garantuar në Komunitet nga kjo Direktivë nuk e pengon transferimin e të dhënave personale në vende të treta që garantojnë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje; se përshtatshmëria e nivelit të mbrojtjes që ofron një vend i tretë duhet të vlerësohet në funksion të të gjitha rrethanave që kanë të bëjnë me një transferim apo një kategori transferimesh;
57. Duke qenë se, nga ana tjetër, transferimi i të dhënave personale në një vend të tretë që nuk ofron një nivel të përshtatshëm të mbrojtjes së të dhënave duhet të jetë i ndaluar;
58. Duke qenë se duhet të parashikohen rastet e përjashtimeve nga ky ndalim në ato rrethana kur subjekti i të dhënave ka dhënë pëlqimin e tij, kur transferimi është i nevojshëm për një kontratë apo një padi ligjore, kur këtë e kërkon mbrojtja e një interesi të rëndësishëm publik, për shembull në rastet e transferimit ndërkombëtar të të dhënave ndërmjet administratave tatimore apo të doganave ose ndërmjet

shërbimeve përgjegjëse për çështjet e sigurimeve shoqërore, ose kur transferimi bëhet nga një regjistër i i parashikuar me ligj dhe që është i destinuar që të konsultohet nga publiku apo personat që kanë një interes legjitim; se në këtë rast një transferim i tillë nuk duhet të përfshijë tërësinë e të dhënave apo të gjithë kategoritë e të dhënave që përmbahen në regjistër dhe, kur regjistri është i destinuar për konsultim nga persona që kanë një interes legjitim, transferimi duhet të bëhet vetëm me kërkesën e atyre personave ose nëse ata do të bëhen marrësit;

59. Duke qenë se mund të merren masa të veçanta për të kompensuar mungesën e mbrojtjes në një vend të tretë në rastet kur kontrolluesi ofron garanci të përshtatshme, se, akoma më tej duhet të parashikohen procedura negociimi ndërmjet Komunitetit dhe vendeve të treta në fjalë;
60. Duke qenë se, në çdo rast, transferimet në vendet e treta mund të kryhen vetëm në përputhje të plotë me dispozitat e miratuara nga Shtetet Anëtare në zbatim të kësaj Direktive, dhe sidomos Nenit 8 të saj;
61. Duke qenë se Shtetet Anëtare dhe Komisioni, në fushat përkatëse të kompetencave, duhet të nxisin bashkimet profesionale dhe organizata të tjera përfaqësuese që janë të interesuara, për të hartuar kode të etikës në mënyrë që të lehtësohet zbatimi i kësaj Direktive, duke marrë parasysh karakteristikat specifike të përpunimit që kryhet në sektorë të caktuar dhe duke respektuar dispozitat kombëtare të miratuara për zbatimin e saj;
62. Duke qenë se ngritja në Shtetet Anëtare e autoriteteve mbikëqyrëse, të cilat i ushtrojnë funksionet e tyre në pavarësi të plotë, është një përbërës thelbësor për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;
63. Duke qenë se këto autoritete duhet të kenë mjetet e duhura për të ushtruar detyrat e tyre, përfshirë kompetenca për hetim dhe ndërhyrje, sidomos në ato raste kur ankesat vijnë nga individë, si dhe kompetenca për t'u përfshirë në procedime ligjore, se këto autoritete duhet të ndihmojnë në garantimin e transparencës së përpunimeve që kryhen në Shtetin Anëtar në juridiksionin e të cilit ata janë;
64. Duke qenë se autoritetet në Shtete të ndryshme Anëtare duhet të ndihmojnë njëri tjetrin në përmbushjen e detyrave të tyre në mënyrë që të sigurohen se rregullat që lidhen me mbrojtjen respektohen në mënyrën e duhur në të gjithë Bashkimin European;
65. Duke qenë se, në nivel Komunitar, një Grup Pune për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale duhet të ngrihet dhe të jetë krejtësisht

i pavarur në ushtrimin e funksioneve të tij; se duke mbajtur parasysh natyrën e tij specifike, ai duhet të këshillojë Komisionin dhe, sidomos të kontribuojë për zbatimin në mënyrë uniforme të dispozitave kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë;

66. Duke qenë se në lidhje me transferimin e të dhënave drejt vendeve të treta, zbatimi i kësaj Direktive kërkon delegimin e kompetencave të zbatimit tek Komisioni si edhe vendosjen e një procedure ashtu siç parashikohet në Vendimin e Këshillit 87/373/KEE (1);

67. Duke qenë se në 20 dhjetor 1994, është arritur një marrëveshje mbi një “modus vivendi” ndërmjet parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit në lidhje me zbatimin e masave për aktet e miratuara në përputhje me procedurën e përcaktuar në Nenin 189 b të Traktatit KE;

68. Duke qenë se, parimet e parashtruara në këtë Direktivë lidhur me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve, por sidomos të drejtën e tyre për jetën private, lidhur me përpunimin e të dhënave personale mund të plotësohen apo sqarohen, sidomos në disa sektorë të caktuar, nga rregulla specifike që bazohen në këto parime;

69. Duke qenë se, është e drejtë që Shteteve Anëtare t'u jepet një periudhë jo më e madhe se tre vjet që nga hyrja në fuqi e dispozitave kombëtare të transpozojnë këtë Direktivë, për t'i lejuar ato që të zbatojnë dispozitat e reja kombëtare në mënyrë progresive për të gjithë ato përpunime që janë në proces; se, në mënyrë që të ndihmohet zbatimi i efektshëm i tyre, do të lejohet një tjetër periudhë 12 vjeçare pas datës në të cilën kjo Direktivë do të miratohet, për të siguruar konformitetin e sistemeve ekzistuese manuale të arkivave me disa prej dispozitave të Direktivës; se, kur të dhënat e përmbajtura në sisteme të tilla arkivimi përpunohen në mënyrë manuale gjatë kësaj periudhe të gjatë tranzicioni, këto sisteme duhet të vihen në përputhje me këto dispozita në kohën e një përpunimi të tillë;

70. Duke qenë se, nuk është e nevojshme që subjekti i të dhënave të japë përsëri pëlqimin e tij në mënyrë që ta lejojë kontrolluesin të vazhdojë përpunimin, pasi dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë direktivë të hyjnë në fuqi, e të dhënave sensitive të nevojshme për përmbushjen e një kontrate të lidhur mbi bazën e pëlqimit të lirë dhe të informuar para hyrjes në forcë të këtyre dispozitave;

71. Duke qenë se kjo Direktivë nuk pengon asnjë Shtet Anëtar në lidhje me veprimtaritë për dërgimin e materialeve publicitare të destinuara për konsumatorët që banojnë në

territorin e atij shteti, me kusht që këto veprimtari të mos kenë lidhje me mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale;

72. Duke qenë se Direktiva lejon që parimet e së drejtës së informimit me dokumentet zyrtare të merren parasysh gjatë zbatimit të parimeve të parashikuara në këtë Direktivë;

KANË MIRATUAR KËTË DIREKTIVË:

KAPITULLI I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Direktivës

1. Në përputhje me këtë Direktivë, Shtetet Anëtare mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të individëve, e sidomos të drejtën e tyre për jetën private për sa i takon përpunimit të të dhënave personale.

2. Shtetet Anëtare nuk mund ta kufizojnë apo ndalojnë qarkullimin e lire të të dhënave personale ndërmjet Shteteve Anëtare për arsye që lidhen me mbrojtjen e garantuar sipas paragrafit 1.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Direktive me:

(a) 'të dhëna personale' kuptohet çdo informacion për një individ (subjekt të dhënash) të identifikuar apo të identifikueshëm; person i identifikueshëm është ai i cili mund të identifikohet, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, sidomos me anë të një numri identifikimi ose të një apo më shumë elementëve specifikë të identitetit të tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor ose social;

(b) 'përpunim i të dhënave personale' ('përpunimi') kuptohet çdo lloj veprimi apo veprimesh të cilat kryhen me të dhënat personale, me apo pa ndihmën e proceseve automatike, si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja apo ndryshimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, hapja me anë të transmetimit, përhapja apo çdo lloj forme tjetër e vënies në dispozicion, renditja ose kombinimi, bllokimi, fshirja ose shkatërrimi;

(c) 'Arkivë me të dhëna personale' ('arkivë') kuptohet çdo grup i strukturuar të dhënash personale që janë të aksesueshme sipas kriterëve të përcaktuar, pavarësisht nga fakti nëse këto të dhëna janë të centralizuara, të decentralizuara apo të shpërndara në mënyrë funksionale apo gjeografike;

(d) 'kontrollues' kuptohet personi fizik ose juridik, autoriteti publik, agjencia apo çdo lloj organizmi tjetër i cili vetëm apo se bashku me të tjerë përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale; në rastet kur qëllimet dhe mënyrat e përpunimit janë të përcaktuar nga dispozita ligjore apo rregulla kombëtare apo komunitare, atëherë kontrolluesi apo kriteret specifike për emërimin e tij mund të përcaktohen nga e drejta kombëtare apo komunitare;

(e) 'përpunues' kuptohet personi fizik ose juridik, autoriteti publik, agjencia apo çdo lloj organizmi tjetër që përpunon të dhëna personale për llogari të kontrolluesit;

(f) 'palë e tretë' kuptohet çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo çdo lloj organizmi tjetër, përveç subjektit të të dhënave, kontrolluesit ose përpunuesit, dhe personave që nën autoritetin e drejtpërdrejtë të kontrolluesit apo përpunuesit janë të autorizuar që të përpunojnë të dhëna;

(g) 'marrës' kuptohet çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo çdo lloj organizmi tjetër, të cilit i përhapen të dhënat, qoftë ky një palë e tretë apo jo. Sidoqoftë, autoritetet që mund të marrin të dhëna në kuadrin e një hetimi të veçantë nuk konsiderohen marrës;

(h) 'pëlqimi i subjektit të të dhënave' kuptohet çdo shfaqje e vullnetit të lirë, specifik dhe të informuar, me anë të të cilit subjekti i të dhënave pranon që të dhënat e tij personale të përpunohen.

Neni 3

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj direktive zbatohen për përpunimin plotësisht apo pjesërisht automatik të të dhënave personale, por edhe për trajtimin jo automatik të të dhënave personale që mbahen në arkiva apo që synohet që të futen në to.

2. Dispozitat e kësaj direktive nuk gjejnë zbatim për përpunimin e të dhënave personale:

- që kryhen për ushtrimin e një veprimtarie që është jashtë fushës së zbatimit të së drejtës komunitare, si ato të parashikuara nga Titulli V dhe VI të Traktatit të Bashkimit Europian si edhe për përpunimet që kanë si objekt sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë e Shtetit (përfshirë mirëqënien ekonomike të Shtetit, kur përpunime të tilla lidhen me sigurinë e Shtetit) dhe veprimtaritë e Shtetit në fushën e drejtësisë penale;

- që kryhet nga një person fizik për ushtrimin e një veprimtarie me karakter krejtësisht personal apo shtëpiak.

Neni 4

E drejta e zbatueshme kombëtare

1. Çdo Shtet Anëtar zbaton dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë për përpunimin e të dhënave personale kur:

(a) përpunimi kryhet në kuadër të veprimtarive të një ndërmarrjeje të kontrolluesit në territorin e një Shteti Anëtar; kur po ky kontrollues është i vendosur në territorin e disa Shteteve Anëtare, ai duhet të marrë masat e nevojshme për t'u siguruar se secila prej këtyre ndërmarrjeve vepron në përputhje me detyrimet e parashtruara nga e drejta e zbatueshme kombëtare;

(b) kontrolluesi nuk është i vendosur në territorin e Shtetit Anëtar por në një vend ku zbatohet e drejta e tij kombëtare për shkak të së drejtës publike ndërkombëtare;

(c) kontrolluesi, që nuk është i vendosur në territorin e Shtetit Anëtar, me qëllim përpunimin e të dhënave personale përdor pajisje automatike ose jo, të vendosura në territorin e shtetit

të sipërpërmendur, përveçse kur këto pajisje përdoren vetëm për qëllime tranziti në territorin e Komunitetit.

2. Në rrethanat e përcaktuara në paragrafin 1 (c), kontrolluesi duhet të caktojë një përfaqësues të vendosur në territorin e Shtetit Anëtar, pa cënuar paditë që mund të ngrihen kundër vetë kontrolluesit.

KAPITULLI II

RREGULLA TË PËRGJITHSHME PËR LIGJSHMËRINË E PËRPUNIMIT TË TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 5

Brenda kufizimeve të dispozitave të këtij Kapitulli, Shtetet Anëtare përcaktojnë në mënyrë më të saktë kushtet sipas të cilave përpunimi i të dhënave personale është i ligjshëm.

SEKSIONI I

PARIMET NË LIDHJE ME CILËSINË E TË DHËNAVE

Neni 6

1. Shtetet Anëtare përcaktojnë se të dhënat personale duhet:

(a) të përpunohen në mënyrë të ndershme dhe të ligjshme;

(b) të mbliidhen për qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme dhe të mos përpunohen më tej, në një mënyrë që bie në kundërshtim me këto qëllime. Përpunimi i mëtejshëm i të dhënave për qëllime historike, statistikore ose shkencore, nuk konsiderohet si i papajtueshëm, nëse Shtetet Anëtare japin garanci të mjaftueshme;

(c) të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe / ose përpunuar më tej dhe mos t'i tejkalojnë këto qëllime.

(d) të jenë të sakta dhe kur është e nevojshme, të përditësuara; duhet të merren të gjitha masat e arsyeshme për t'u siguruar se të dhënat që janë të pasakta ose të paplota, duke

mbajtur parasysht qëllimet për të cilat ato janë mbledhur apo për të cilat përpunohen më tej, të fshihen apo të korrigojnë;

(e) të mbahen në një formë e cila e lejon identifikimin e subjekteve të të dhënave për një periudhë kohore që nuk është më e gjatë nga ç'është e nevojshme për të përmbushur qëllimet për të cilat të dhënat u mbledhën apo janë përpunuar më tej. Shtetet Anëtare parashikojnë garanci të mjaftueshme për të dhënat personale që ruhen për periudha më të gjata kohore, për përdorim historik, statistikor ose shkencor.

2. Kontrolluesi garanton zbatimin e paragrafit 1.

SEKSIONI II

KRITERET QË E BËJNË PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE TË LIGJSHËM

Neni 7

Shtetet Anëtare përcaktojnë se të dhënat personale mund të përpunohen vetëm nëse:

(a) subjekti i të dhënave ka shprehur pëlqimin e tij në mënyrë të qartë; ose

(b) kur përpunimi është i nevojshëm për zbatimin e një kontrate në të cilën subjekti i të dhënave është palë apo për marrjen e masave me kërkesë të subjektit të të dhënave, para lidhjes së një kontrate; ose

(c) kur përpunimi është i nevojshëm për të përmbushur një detyrim ligjor të kontrolluesit; ose

(d) kur përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetësorë të subjektit të të dhënave; ose

(e) kur përpunimi është i nevojshëm për përmbushjen e një detyre me interes publik apo kur lidhet me ushtrimin e autoritetit publik të kontrolluesit apo të palës së tretë të cilës i janë përhapur të dhënat; ose

(f) kur përpunimi është i nevojshëm për qëllimet e interesave legjitimë të kontrolluesit apo palëve të treta të cilave u janë përhapur të dhënat, me kusht që këto interesa të mos

mbizotërojnë mbi interesat apo të drejtat dhe liritë themelore të subjektit të të dhënave, të cilat kërkojnë mbrojtje sipas kuptimit të Nenit 1, paragrafi 1.

SEKSIONI III

KATEGORITË E VEÇANTA TË PËRPUNIMEVE

Neni 8

Përpunimet që lidhen me kategori të veçanta të të dhënave

1. Shtetet Anëtare e ndalojnë përpunimin e të dhënave personale që tregojnë origjinën racore apo etnike, bindjet politike, besimin fetar apo filozofik, anëtarësinë në sindikata, dhe përpunimin e të dhënave që lidhen me shëndetin apo jetën seksuale.

2. Paragrafi 1 nuk zbatohet në rastet kur:

(a) subjekti i të dhënave ka dhënë qartë pëlqimin e tij për përpunimin e këtyre të dhënave, përveç rasteve kur në legjislacionin e Shtetit Anëtar parashikohet se pëlqimi i subjektit të të dhënave, nuk është i mjaftueshëm për të shmangur zbatimin e paragrafit 1; ose

(b) kur përpunimi është i nevojshëm për të përmbushur detyrimet dhe të drejtat specifike të kontrolluesve në fushën e të drejtës së punës, deri në atë masë që vetë përpunimi të jetë i autorizuar nga e drejta kombëtare që parashikon garanci të përshtatshme; ose

(c) kur përpunimi është i nevojshëm për të mbrojtur interesat jetësorë të subjektit të të dhënave apo të një pale të tretë në rastet kur subjekti i të dhënave është fizikisht apo ligjërisht i paaftë për të dhënë pëlqimin e tij; ose

(d) kur përpunimi kryhet me garancitë e mjaftueshme gjatë ushtrimit të veprimtarive legjitime të një fondacioni, shoqate apo ndonjë organizmi tjetër jofitimprurës që ka një qëllim politik, filozofik, fetar apo sindikalist dhe me kushtin që përpunimi të jetë i lidhur vetëm me anëtarët e këtij organizmi apo me personat që kanë kontakte të rregullta me të lidhur me qëllimet e tij si edhe që të dhënat të mos i përhapen një pale të tretë pa pëlqimin e subjekteve të të dhënave; ose

(e) kur përpunimi lidhet me të dhëna që janë bërë haptazi publike nga subjekti i të dhënave apo që janë të nevojshme për të vendosur, ushtruar apo për të mbrojtur një të drejtë në rrugë gjyqësore;

3. Paragrafi 1 nuk gjen zbatim atëherë kur përpunimi i të dhënave është i nevojshëm për qëllime të profilaksisë, diagnostikimit mjekësor, ofrimit të kujdesit, trajtimit ose menaxhimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, dhe kur këto të dhëna përpunohen nga një profesionist në fushën e shëndetësisë që sipas të drejtës kombëtare apo rregullave të miratuara nga autoritetet kompetente kombëtare, është i detyruar që të ruajë sekretin profesional, apo nga ndonjë person tjetër që ka gjithashtu detyrimin ekuivalent të ruajtjes së sekretit profesional.

4. Nëse parashikohen garancitë e përshtatshme, Shtetet Anëtare për motive të interesave të rëndësishëm publikë, përcaktojnë përjashtime të tjera veç atyre të parashikuara në paragrafin 2 ose nëpërmjet një ligji kombëtar ose nëpërmjet një vendimi të autoritetit mbikëqyrës.

5. Përpunimi i të dhënave që lidhen me kundërvajtjet penale, dënimet penale apo masat e sigurisë mund të kryhen vetëm nëpërmjet kontrollit të autoritetit publik, apo nëse jepen garanci specifike të përshtatshme mbi bazën e së drejtës kombëtare, pa paragjykuar derogimet që mund të jepen nga Shteti Anëtar mbi bazën e një dispozite kombëtare e cila jep garanci specifike të përshtatshme. Megjithatë, një regjistër i plotë i dënimeve penale mund të mbahet vetëm nën kontrollin e autoritetit publik.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që të dhënat që lidhen me sanksionet administrative apo procedime për çështje civile, të përpunohen gjithashtu nën kontrollin e autoritetit publik.

6. Derogimet nga paragrafi 1, të parashikuara në paragrafet 4 dhe 5, i njoftohen Komisionit.

7. Shtetet Anëtare përcaktojnë kushtet në të cilat mund të jetë objekt i përpunimit një numër kombëtar identifikimi apo ndonjë lloj mjeti tjetër i përgjithshëm identifikimi.

Neni 9

Përpunimi i të dhënave personale dhe liria e shprehjes

Shtetet Anëtare parashikojnë përjashtime ose derogime ndaj dispozitave të këtij Kapitulli, Kapitullit IV dhe Kapitullit VI, për përpunimin e të dhënave personale që kryhet krejtësisht për qëllime gazetarie ose për qëllime të shprehjes letrare dhe artistike, vetëm atëherë kur këto përpunime janë të nevojshme për të përpunur të drejtën për jetën private me dispozitat që rregullojnë lirinë e shprehjes.

SEKSIONI IV

INFORMIMI I SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE

Neni 10

Informimi në rastet e mbledhjes së informacionit nga subjekti i të dhënave

Shtetet Anëtare përcaktojnë se kontrolluesi ose përfaqësuesi i tij duhet t'i japin subjektit të të dhënave nga i cili janë mbledhur të dhëna rreth tij, të paktën informacionet e renditura më poshtë, përveç rasteve kur ai e ka këtë informacion:

(a) identitetin e kontrolluesit dhe të përfaqësuesit të tij, nëse ka;

(b) qëllimet me të cilat synohet të përpunohen të dhënat;

(c) informacione të tjera si vijon

- marrësit ose kategoritë e marrësve të të dhënave,

- nëse t'u përgjigjesh pyetjeve është e detyrueshme apo mbi bazë vullnetare si edhe nëse ka pasoja të mundshme nëse nuk jepet përgjigje,

-nëse ekziston e drejta për t'i aksesuar të dhënat dhe e drejta për t'i korrigjuar të dhënat e tij deri në masën që, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike në të cilat të dhënat janë mbledhur, informacione të tilla janë të nevojshme për të kryer një përpunim të drejtë kundrejt subjektit të të dhënave.

Neni 11

Informimi kur të dhënat nuk janë mbledhur nga subjekti i të dhënave

1. Kur të dhënat nuk janë marrë nga subjekti i të dhënave, Shtetet Anëtare marrin masa që në momentin e regjistrimit të të dhënave apo nëse parashikohet përhapja e të dhënave tek një palë e tretë, jo më vonë se koha kur të dhënat u përhapën për herë të parë, kontrolluesi ose përfaqësuesi i tij duhet t'i japë subjektit të të dhënave të paktën informacionet e renditura më poshtë, përveçse kur ky person është informuar më parë:

(a) identitetin e kontrolluesit dhe të përfaqësuesit të tij, nëse ka;

(b) qëllimet e përpunimit;

(c) informacione të tjera si vijon:

- kategoritë e të dhënave në fjalë,

- marrësit ose kategoritë e marrësve,

- ekzistencën e të drejtës së aksesit dhe të drejtës për të korrigjuar të dhënat që lidhen me të deri në masën që, duke marrë në konsideratë rrethanat specifike në të cilat mblidhen të dhënat, informacione të tilla të jenë të nevojshme për të kryer një përpunim të drejtë kundrejt subjektit të të dhënave.

2. Dispozitat e paragrafit 1 nuk gjejnë zbatim kur, sidomos gjatë përpunimit të të dhënave për qëllime statistikore, ose për kërkime historike ose shkencore, informimi i subjektit të të dhënave rezulton i pamundur apo do të kërkonte përpjekje të tepërta ose kur regjistrimi apo përhapja janë të parashikuara me ligj. Në këto raste Shtetet Anëtare japin garancitë e duhura.

SEKSIONI V

E DREJTA E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PËR TË AKSESUAR TË DHËNAT

Neni 12

E drejta për akses

Shtetet Anëtare i garantojnë çdo subjekti të të dhënave, të drejtën që të marrin nga kontrolluesi:

(a) lirisht e pa kufizime, në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa apo shpenzime të

tepërta:

- konfirmimin nëse të dhënat e tij janë duke u përpunuar apo jo dhe informacion të paktën për qëllimet e përpunimit, kategoritë e të dhënave të përpunuara si edhe marrësit apo kategoritë e marrësve të cilëve u përhapen të dhënat,

- komunikimin në një mënyrë të kuptueshme të të dhënave që po përpunohen dhe të gjithë informacioneve të disponueshme mbi origjinën e të dhënave,

- njohuri mbi logjikën që përdoret në përpunimet automatike të të dhënave të tij, të paktën në rastet e vendimeve automatike të përmendura në Nenin 15 paragrafi 1;

(b) sipas rastit, korrigjimin, fshirjen ose bllokimin e përpunimit të të dhënave që nuk është në përputhje me dispozitat e kësaj Direktive, sidomos për shkak të natyrës së paplotë ose të pasaktë të të dhënave;

(c) njoftimin e palëve të treta, të cilëve u përhapen të dhënat, për çdo lloj korrigjimi, fshirjeje ose bllokimi të kryer në përputhje me shkronjën (b), nëse nuk rezulton se kjo është e pamundur apo kërkon një përpjekje të jashtëzakonshme.

SEKSIONI VI

PËRJASHTIMET DHE KUFIZIMET

Neni 13

Përrjashtimet dhe kufizimet

1. Shtetet Anëtare mund të miratojnë masa ligjore për të kufizuar fushën e zbatimit të detyrimeve dhe të drejtave të parashikuara në Nenet 6 (1), 10, 11 (1), 12 dhe 21 kur një kufizim i tillë përbën një masë të nevojshme për ruajtjen e:

(a) sigurisë kombëtare;

(b) mbrojtjes;

(c) sigurisë publike;

(d) parandalimin, hetimin, zbulimin dhe procedimin e veprave penale, ose të shkeljeve të etikës për profesionet e rregulluara;

(e) një interesi të rëndësishëm ekonomik ose financiar të një Shteti Anëtar ose Bashkimit European, edhe në çështjet monetare, buxhetore e tatimore;

(f) një funksioni monitorues, inspektues ose rregullator të lidhur, qoftë edhe herë pas here, me ushtrimin e autoritetit publik në rastet e përmendura në shkronjat c), d) dhe e);

(g) mbrojtjen e subjektit të të dhënave ose të të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

2. Nëse përmbushen garancitë e përshtatshme ligjore, që përjashtojnë sidomos përdorimin e të dhënave për marrjen e masave apo vendimeve që kanë të bëjnë me ndonjë individ në veçanti, Shtetet Anëtare mundet, kur nuk ka rrezik të qartë për shkeljen e jetës private të subjektit të të dhënave, që të kufizojnë me anë të një mase ligjore të drejtat e parashikuara në Nenin 12 kur të dhënat përpunohen vetëm për qëllime të kërkimeve shkencore ose mbahen në një formë personale për një periudhë që nuk e kalon kohën e nevojshme me qëllim krijimin e statistikave.

SEKSIONI VII

E DREJTA E SUBJEKTIT TË TË DHËNAVE PËR TË KUNDËRSHTUAR

Neni 14

E drejta e subjektit të të dhënave për të kundërshtuar

Shtetet Anëtare i japin subjektit të të dhënave të drejtën:

(a) të paktën në rastet e përmendura në Nenin 7 (e) dhe (f), për të kundërshtuar në çdo moment, për motive detyruese ligjore që lidhen me situatën e tij të veçantë, përpunimin e të dhënave që mbahen për të, përveçse kur përcaktohet ndryshe nga e drejta e brendshme. Në rastet kur ka një kundërshtim të justifikuar, përpunimi i kryer nga kontrolluesi nuk mund t'i përfshijë më këto të dhëna;

(b) për të kundërshtuar, me anë të një kërkesë dhe pa pagesë, përpunimin e të dhënave personale që mbahen për të, të cilat kontrolluesi parashikon t'i përpunojë për qëllime të

tregtimit të drejtpërdrejtë, apo që të informohet përpara se të dhënat personale t'i përhapen për herë të parë palëve të treta, apo të përdoren në emrin e tyre për qëllime të dërgimit të materialeve publicitare; subjekti i të dhënave duhet të informohet në mënyrë të qartë për të drejtën që ai gëzon për ta kundërshtuar pa pagesë këtë përhapje apo përdorim.

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për t'u siguruar se subjektet e të dhënave janë në dijeni të ekzistencës së të drejtës së përmendur në nënparagrafin e parë të shkronjës b).

Neni 15

Vendime individuale automatike

1. Shtetet Anëtare njohin të drejtën e çdo personi që të mos i nënshtrohet një vendimi që prodhon efekte juridike për të apo që ndikon tek ai në mënyrë të tepërt dhe që bazohet vetëm në përpunimin automatik të të dhënave që synojnë vlerësimin e disa aspekteve të personalitetit të tij, si për shembull, rendimentin e tij në punë, sigurinë, besueshmërinë, sjelljen etj.

2. Në përputhje me nenet e tjera të kësaj Direktive, Shtetet Anëtare parashikojnë që një person mund të jetë subjekt i një vendimi të këtij lloji sipas paragrafit 1, nëse një vendim i tillë:

(a) merret në kontekstin e lidhjes apo ekzekutimit të një kontrate, me kusht që kërkesa e paraqitur nga subjekti i të dhënave për lidhjen apo ekzekutimin e kontratës, të jetë përmbushur apo që të merren masa të përshtatshme për të ruajtur interesat e tij të ligjshëm mes të cilave mundësia për të shpjeguar këndvështrimin e tij; ose

(b) autorizohet nga një ligj që parashtron gjithashtu masat për të garantuar interesat legjitimë të subjektit të të dhënave.

SEKSIONI VIII

KONFIDENCIALITETI DHE SIGURIA E PËRPUNIMEVE

Neni 16

Konfidencialiteti i përpunimit

Çdo person që vepron nën autoritetin e kontrolluesit ose të përpunuesit, përfshirë vetë përpunuesin, nuk duhet t'i përpunojë të dhënat personale tek të cilat ka akses pa autorizimin e kontrolluesit, përveçse kur detyrohet me ligj.

Neni 17

Siguria e përpunimit

1. Shtetet Anëtare parashikojnë se kontrolluesi duhet të verë në jetë masa të përshtatshme teknike dhe organizative për të mbrojtur të dhënat personale kundër shkatërrimit aksidental apo të paligjshëm, humbjes aksidentale, ndryshimit, përhapjes ose aksesit të paautorizuar, sidomos kur përpunimi përfshin transmetimin e të dhënave me anë të një rrjeti, dhe kundër gjithë formave të tjera të paligjshme të përpunimit.

Duke mbajtur parasysh shkallën më të lartë të zhvillimit si edhe koston e zbatimit, masa të tilla do të garantojnë një nivel sigurie që është i përshtatshëm për rreziqet që paraqet përpunimi dhe natyra e të dhënave që duhen mbrojtur.

2. Shtetet Anëtare parashikojnë se kontrolluesi, kur përpunimi kryhet për llogari të tij, duhet të zgjedhë një përpunues që paraqet garanci të mjaftueshme për sa i takon masave të sigurisë teknike dhe organizative të përpunimeve që do të kryhen, dhe duhet të veprojë në përputhje me ato masa.

3. Kryerja e përpunimit me anë të përpunuesit, duhet të rregullohet me anë të një kontrata apo të një akti juridik i cili e lidh përpunuesin me kontrolluesin dhe që parashikon në veçanti që:

-përpunuesi vepron vetëm mbi bazën e udhëzimeve nga kontrolluesi,

-detyrimet e parashikuara në paragrafin 1, ashtu siç përcaktohet nga e drejta e Shtetit Anëtar në të cilin është vendosur përpunuesi, detyrojnë edhe këtë të fundit.

4. Me qëllim ruajtjen e provave, ato elementë të kontratës apo të aktit ligjor që lidhen me mbrojtjen e të dhënave dhe me kërkesat që lidhen me masat e përmendura në paragrafin

1, paraqiten me shkrim apo në ndonjë formë tjetër ekuivalente.

SEKSIONI IX

NJOFTIMI

Neni 18

Detyrimi për të njoftuar autoritetin mbikëqyrës

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që kontrolluesi ose përfaqësuesi i tij, nëse ka, duhet të njoftojnë autoritetin mbikëqyrës të përmendur në Nenin 28 para kryerjes së ndonjë përpunimi apo grupi përpunimesh, krejtësisht apo pjesërisht automatike që synohet t'i shërbejnë një qëllimi të vetëm apo disa qëllimeve të lidhura me të.

2. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë thjeshtimin ose përjashtimin nga njoftimi vetëm në rastet dhe me kushtet e mëposhtme:

- kur bëhet fjalë për kategori përpunimi që, duke marrë në konsideratë të dhënat që do të përpunohen, nuk ka gjasa që të çenojnë të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave, që specifikojnë qëllimet e përpunimit, të dhënat apo kategoritë e të dhënave që i nënshtrohen përpunimit, kategorinë apo kategoritë e subjekteve të të dhënave, marrësit apo kategoritë e marrësve të cilëve do t'u përhapen të dhënat dhe kohëzgjatjen e ruajtjes së të dhënave dhe/ose

-kur kontrolluesi, në përputhje me të drejtën e brendshme të zbatueshme, ngarkon një nëpunës për mbrojtjen e të dhënave personale që është përgjegjës sidomos:

-për të siguruar në një mënyrë të pavarur zbatimin e brendshëm të dispozitave të brendshme të marra në përputhje me këtë Direktivë

-për mbajtjen e regjistrit të përpunimeve të kryera nga kontrolluesi, ku gjenden edhe informacionet e përmendura në Nenin 21 (2),

kësisoj duke garantuar se të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave nuk ka gjasa që të cënohen prej operacioneve të përpunimit.

3. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë se paragrafi 1 nuk gjen zbatim tek përpunimet qëllimi i vetëm i të cilëve është mbajtja e një regjistri i cili sipas ligjeve dhe rregullava synohet që të japë informacion për publikun dhe që është i hapur për konsultim qoftë nga publiku në përgjithësi, qoftë nga çdo person që mund të dëshmojë një interes legjitim.

4. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë një përjashtim nga detyrimi për njoftim ose një thjeshtim të njoftimit në rastet e operacioneve të përpunimit të parashikluara në Nenin 8 (2) (d).

5. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë se për disa ose për të gjitha operacionet e përpunimit jo automatik që kanë të bëjnë me të dhëna personale, do të bëhet njoftim, ose parashikojnë që këto operacione përpunimi do të jenë subjekt i një njoftimi të thjeshtuar.

Neni 19

Përmbajtja e Njoftimit

1. Shtetet Anëtare specifikojnë informacionet që duhet të përmbahen tek njoftimi. Ai duhet të përfshijë të paktën:

(a) emrin dhe adresën e kontrolluesit dhe të përfaqësuesit të tij, nëse ka;

(b) qëllimin ose qëllimet e përpunimit;

(c) një përshkrim të kategorisë ose kategorive të subjekteve të të dhënave dhe të të dhënave ose kategoritë e të dhënave që lidhen me to;

(d) marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve mund t'u përhapen të dhënat;

(e) transferimet e propozuara të të dhënave në vendet e treta;

(f) një përshkrim të përgjithshëm që lejon vlerësimin paraprak të përshtatshmërisë së masave të marra në përputhje me Nenin 17 për të garantuar sigurinë e përpunimit.

2. Shtetet Anëtare specifikojnë procedurat sipas të cilave çdo ndryshim që ndikon në informacionin e parashikuar në paragrafin 1, duhet të njoftohet tek autoriteti mbikëqyrës.

Neni 20

Kontrolli paraprak

1. Shtetet Anëtare përcaktojnë se cilat janë ato operacione përpunimi që ka gjasa të paraqesin rreziqe specifike për të drejtat dhe liritë e subjekteve të të dhënave dhe sigurohen që këto operacione përpunimi kontrollohen para se të nisin.
2. Këto kontrole paraprake kryhen nga autoriteti mbikëqyrës pas marrjes së një njoftimi nga ana e kontrolluesit ose nga nëpunësi i mbrojtjes së të dhënave, i cili, në raste dyshimesh, duhet të konsultohet me autoritetin mbikëqyrës.
3. Shtetet Anëtare mund të kryejnë kontrole të tilla edhe gjatë procesit të hartimit të një akti të Parlamentit Kombëtar, ose në bazë të një mase që bazohet në një masë të tillë legislative, në të cilën përcaktohet lloji i përpunimit dhe ku përcaktohen garancitë e duhura.

Neni 21

Publikimi i përpunimeve

1. Shtetet Anëtare marrin masa për të siguruar publikimin e përpunimeve.
2. Shtetet Anëtare duhet të marrin masa që autoriteti mbikëqyrës të mbajë një regjistër për përpunimet e njoftuara në përputhje me Nenin 18.

Regjistri do të mbajë të paktën informacionin e renditur në Nenin 19 (1) (a) deri në (e).

Regjistri mund të konsultohet nga çdo njeri.

3. Shtetet Anëtare marrin masa në lidhje me relacionet e përpunimit që nuk janë objekti i njoftimit, që kontrolluesit apo ndonjë organizëm tjetër i emëruar nga Shtetet Anëtare, të venë në dispozicion të kujtdo që bën kërkesë, të paktën informacionin e përmendur në Nenin 19 (1) (a) deri në (e) në një formë të përshtatshme.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që kjo dispozitë të mos zbatohet për përpunimet qëllimi i vetëm i të cilave është mbajtja e një regjistri që sipas legjislacionit apo rregullave synohet që të japë informacion për publikun dhe që është i hapur për konsultime qoftë nga publiku në përgjithësi apo nga çdo person që mund të dëshmojë një interes legjitim.

KAPITULLI III

ZGJIDHJET LIGJORE, PËRGJEGJËSIA DHE SANKSIONET

Neni 22

Zgjidhjet Ligjore

Pa paragjykuar zgjidhjet administrative të cilat mund të parashikohen, mes të tjerash para autoritetit mbikëqyrës të përmendur në Nenin 28, para delegimit tek autoriteti gjyqësor, Shtetet Anëtare garantojnë të drejtën e çdo njeriu për zgjidhje ligjore për çdo shkelje të të drejtave që i garantohen nga e drejta e zbatueshme kombëtare, për përpunimin në fjalë.

Neni 23

Përgjegjësia ligjore

1. Shtetet Anëtare parashikojnë që çdo person që është dëmtuar si pasojë e një përpunimi të paligjshëm apo të një veprimi që nuk është në përputhje me dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë, ka të drejtën që të dëmshpërblehet nga kontrolluesi për dëmin që i është shkaktuar.
2. Kontrolluesi mund të përjashtohet nga kjo përgjegjësi, tërësisht ose pjesërisht, nëse provon se ai nuk është përgjegjës për ngjarjen që ka shkaktuar dëmin.

Neni 24

Sanksionet

Shtetet Anëtare miratojnë masa të përshtatshme për të garantuar zbatimin e plotë të dispozitave të kësaj Direktive dhe përcaktojnë në veçanti sanksionet që vendosen në rast të shkeljeve të dispozitave që miratohen në përputhje me këtë Direktivë.

KAPITULLI IV

TRANSFERIMI I TË DHËNAVE PERSONALE NË VENDET E TRETË

Neni 25

Parimet

1. Shtetet Anëtare parashikojnë se transferimet drejt një vendi të tretë të të dhënave personale që janë duke u përpunuar apo që synohet të përpunohen pas transferimit, mund të kryhen vetëm nëse, vendi i tretë në fjalë garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje, pa paragjykuar përputhshmërinë me dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me dispozita të tjera të kësaj Direktive.
2. Mjaftueshmëria e nivelit të mbrojtjes që garantohet nga një vend i tretë vlerësohet nën dritën e të gjitha rrethanave që lidhen me një transferim ose me një kategori transferimesh të të dhënave; merret veçanërisht në konsideratë natyra e të dhënave, qëllimet dhe kohëzgjatja e përpunimit apo përpunimeve të propozuara, vendi i origjinës dhe vendi i destinacionit përfundimtar normat e së drejtës të përgjithshme apo sektoriale që janë në forcë në vendin e tretë në fjalë si edhe rregullat profesionale si edhe masat e sigurisë të cilat zbatohen në atë vend.
3. Shtetet Anëtare dhe Komisioni informojnë njëri tjetrin për ato raste në të cilat ata janë të opinionit se një vend i tretë nuk garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje sipas kuptimit të paragrafit 2.
4. Sa herë që Komisioni konstaton, sipas procedurës së përcaktuar në Nenin 31 (2), se një vend i tretë nuk garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje sipas kuptimit të paragrafit 2 të këtij Neni, Shteti Anëtar merr masat e nevojshme për të parandaluar transferime të dhënash të të njëjtit lloj tek vendi i tretë në fjalë.
5. Komisioni nis, në momentin e duhur, negociatat për të gjetur zgjidhje për situatën që rezulton prej konstatimit të bërë në përputhje me paragrafin 4.
6. Komisioni mund të konstatojë, në përputhje me procedurën e përmendur në Nenin 31 (2), se një vend i tretë garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje sipas kuptimit të

paragrafit 2 të këtij Neni, për shkak të legjislacionit të tij të brendshëm ose të angazhimeve ndërkombëtare, sidomos të atyre të ndërmarra si pasojë e negociatave të përmendura në paragrafin 5, për mbrojtjen e jetës private apo të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të vepruar në përputhje me vendimin e Komisionit.

Neni 26

Derogimet

1. Duke deroguar nga Neni 25 dhe përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga e drejta e brendshme që rregullon raste të veçanta, Shtetet Anëtare marrin masa që një transferim apo grup transferimesh të të dhënave personale në një vend të tretë që nuk garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje sipas kuptimit të Nenit 25 (2) mund të kryhet me kusht që:

(a) subjekti i të dhënave të ketë dhënë haptazi pëlqimin e tij për transferimin e propozuar; ose

(b) transferimi të jetë i nevojshëm për ekzekutimin e një kontrate ndërmjet subjektit të të dhënave dhe kontrolluesit apo për zbatimin e masave parakontraktuale të marra me kërkesë të subjektit të të dhënave; ose

(c) transferimi të jetë i nevojshëm për ekzekutimin e një kontrate të lidhur në interes të subjektit të të dhënave ndërmjet kontrolluesit dhe një pale të tretë;ose

(d) transferimi të jetë i nevojshëm apo i parashikuar me ligj për mbrojtjen e një interesi të rëndësishëm publik apo për të konstatuar, ushtruar apo mbrojtur një të drejtë në rrugë gjyqësore; ose

(e) transferimi të jetë i nevojshëm në mënyrë që të mbrohen interesat jetësorë të subjektit të të dhënave; ose

(f) transferimi bëhet nga një regjistër i cili sipas ligjeve ose rregulloreve synohet që të japë informacion për publikun dhe që është i hapur për konsultim si nga publiku ashtu edhe nga

kushdo që mund të dëshmojë një interes legjitim, deri në masën që për rastin specifik të respektohen kushtet që ligji parashikon për konsultimet.

2. Pa paragjykuar paragrafin 1, një Shtet Anëtar mund të autorizojë një transferim apo grup transferimesh të të dhënave personale në një vend të tretë i cili nuk garanton një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje sipas kuptimit të Nenit 25 (2), atëherë kur kontrolluesi paraqet garanci të mjaftueshme për mbrojtjen e jetës private dhe të drejtave e lirive themelore të njeriut si edhe për sa i takon ushtrimit të të drejtave që lidhen me to; garanci të tilla mund të rezultojnë sidomos nga klauzola të përshtatshme kontraktuale.

3. Shteti Anëtar informon Komisionin dhe Shtetet e tjera Anëtare në lidhje me autorizimin që ai jep në përputhje me nenin 2.

Nëse një Shtet Anëtar ose Komisioni kundërshton në mënyrë të arsyetuar në lidhje me mbrojtjen e jetës private dhe lirive e të drejtave themelore të njeriut, Komisioni merr masat e duhura në përputhje me procedurën e parashikuar në Nenin 31 (2).

Shtetet Anëtare marrin masat e nevojshme për të vepruar në përputhje me vendimin e Komisionit.

4. Sa herë që Komisioni vendos, në përputhje me procedurën e përmendur në Nenin 31 (2), se disa klauzola kontraktuale tip ofrojnë garancitë e mjaftueshme sipas paragrafit 2, Shtetet Anëtare do të marrin masat e duhura për të vepruar në përputhje me vendimin e Komisionit.

KAPITULLI V

KODET E ETIKËS

Neni 27

1. Shtetet Anëtare dhe Komisioni nxisin hartimin e kodeve të etikës që synojnë të kontribuojnë në zbatimin e saktë të dispozitave kombëtare të miratuara nga Shtetet Anëtare në përputhje me këtë Direktivë, duke marrë parasysh specifikat sektoriale.

2. Shtetet Anëtare marrin masa që bashkimet profesionale dhe organizma të tjerë që përfaqësojnë kategori të tjera kontrolluesish që kanë hartuar variante paraprake të kodeve kombëtare apo që synojnë të ndryshojnë apo të zgjerojnë kodet kombëtare ekzistuese, të mund t'i paraqesin ato për mendim tek autoriteti kombëtar.

Shtetet Anëtare marrin masa që ky autoritet të sigurohet, në veçanti, që përputhshmëria e projekteve që i janë paraqitur janë në përputhje me dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë. Nëse e sheh të përshtatshme, autoriteti mbledh këndvështrimet e subjekteve të të dhënave apo përfaqësuesve të tyre.

3. Projekt kodet komunitare dhe ndryshimet apo zgjerimet e kodeve ekzistuese komunitare, mund t'i paraqiten Grupit të punës të përmendur në Nenin 29. Ky Grup Pune përcakton, mes të tjerash, nëse projektet që i janë paraqitur janë në përputhje me dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë. Nëse e sheh të arsyeshme, autoriteti kërkon këndvështrimet e subjekteve të të dhënave ose të përfaqësuesve të tyre. Komisioni mund të garantojë përhapjen e përshtatshme të kodeve që janë miratuar më parë nga Grupi i Punës.

KAPITULLI VI

AUTORITETI MBIKËQYRËS DHE GRUPI I PUNËS PËR MBROJTJEN E INDIVIDËVE NË LIDHJE ME PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 28

Autoriteti Mbikëqyrës

1. Çdo shtet anëtar merr masa që një apo më shumë autoritete publike janë përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin brenda territorit të tij të dispozitave të miratuara nga Shtetet Anëtare në përputhje me këtë Direktivë.

Këto autoritete janë krejtësisht të pavarura në ushtrimin e funksioneve që u janë besuar.

2. Çdo Shtet Anëtar merr masa që autoritetet mbikëqyrëse të konsultohen gjatë hartimit të masave administrative apo rregullave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale.

3. Çdo autoritet mbikëqyrës pajiset sidomos me:

- kompetenca hetuese, si për shembull kompetenca për të aksesuar të dhënat që janë objekt i përpunimit dhe kompetenca për të mbledhur gjithë informacionin e nevojshëm për ushtrimin e funksionit të vet mbikëqyrës,

- kompetenca efikase ndërhyrjeje, si për shembull atë të formulimit të opinioneve përpara nisjes së përpunimeve, në përputhje me Nenin 20, dhe garantimin e publikimit të duhur të këtyre opinioneve, të urdhërimit të bllokimit, fshirjes apo shkatërrimit të të dhëave, të vendosjes së një ndalimi të përkohshëm apo të përhershëm të përpunimit, të paralajmërimit apo qortimit të kontrolluesit, ose atë të delegimit të çështjes në parlamentet kombëtare apo në institucione të tjera politike,

- kompetencën për t'u përfshirë në procedime ligjore në rastet kur dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë janë shkelur apo për t'i sjellë këto shkelje në vëmendjen e autoriteteve gjyqësore.

Vendimet e autoritetit mbikëqyrës që shkaktojnë ankesa, mund të apelojnë nëpërmjet gjykatave.

4. Çdo person apo çdo shoqatë që përfaqëson atë person, mund t'i paraqesë autoritetit mbikëqyrës një kërkesë në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tij themelore duke patur parasysh përpunimin e të dhënave. Subjekti i të dhënave do të informohet për rezultatin e kërkesës.

Çdo person mundet që, veçanërisht, t'i kërkojë një autoriteti mbikëqyrës që të verifikojë ligjshmërinë e një përpunimi të të dhënave në rastet kur gjejnë zbatim dispozitat kombëtare të miratuara në përputhje me Nenin 13 të kësaj Direktive. Në çdo rast, personi informohet se është kryer një kontroll [verifikim].

5. Çdo autoritet mbikëqyrës harton një raport periodik mbi veprimtarinë e tij. Ky raport bëhet publik.

6. Çdo autoritet mbikëqyrës, pavarësisht nga e drejta kombëtare e zbatueshme për përpunimin në fjalë, është kompetent për ushtrimin, në territorin e Shtetit Anëtar ku

ndodhet, kompetencat që i janë deleguar sipas paragrafit 3. Çdo autoriteti mund t'i kërkojë që të ushtrojë kompetencat e veta nga një autoritet i një Shteti tjetër Anëtar.

Autoritetet Mbikëqyrëse bashkëpunojnë me njëri tjetrin deri në masën që është e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, sidomos duke shkëmbyer informacione të dobishme.

7. Shtetet Anëtare marrin masa që anëtarët dhe stafi i autoritetit mbikëqyrës, edhe pas përfundimit të punësimit, të jenë subjekt i detyrimit për ruajtjen e sekretit profesional, për sa i takon informacionit konfidencial tek i cili ata kanë akses.

Neni 29

Grupi i Punës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale

1. Me anë të kësaj, ngrihet një Grup Pune për Mbrojtjen e Personave në lidhje me Përpunimin e të Dhënave Personale, këtej e tutje të quajtur Grupi i Punës.

Grupi i Punës ka karakter konsultiv dhe të pavarur.

2. Grupi i Punës përbëhet nga një përfaqësues i autoritetit apo autoriteteve mbikëqyrëse nga secili Shtet Anëtar dhe nga një përfaqësues i autoritetit apo autoriteteve të krijuara për institucionet dhe organet komunitare dhe nga një përfaqësues i Komisionit.

Çdo anëtar i Grupit të Punës caktohet nga institucioni, autoriteti apo autoritetet që ai përfaqëson. Atëherë kur një Shtet Anëtar ka caktuar më shumë se një autoritet mbikëqyrës, atëherë ato emërojnë një përfaqësues të përbashkët. E njëjta gjë vlen edhe për autoritetet e krijuara për institucionet dhe organet komunitare.

3. Grupi i Punës i merr vendimet me anë të një shumice të thjeshtë të përfaqësuesve të autoriteteve mbikëqyrëse.

4. Grupi i Punës zgjedh presidentin e tij. Presidenti zgjidhet për një mandat 2- vjeçar me të drejtë rizgjedhjeje.

5. Sekretariati i Grupit të Punës sigurohet nga Komisioni.

6. Grupi i punës miraton rregulloren e vet të brendshme.

7. Grupi i Punës shqyrton çështjet e vendosura në rendin e ditës nga presidenti i tij, qoftë me nismën e vet apo me kërkesë të një përfaqësuesi të autoriteteve mbikëqyrëse ose me kërkesë të Komisionit.

Neni 30

1. Grupi i punës ka detyrat e mëposhtme:

(a) të shqyrtojë çdo çështje që mbulon zbatimin e masave kombëtare të miratuara sipas kësaj Direktive në mënyrë që të kontribuojë për një zbatim të njëtrajtshëm të këtyre masave;

(b) t'i paraqesë Komisionit një opinion mbi nivelin e mbrojtjes në Komunitet dhe në vendet e treta;

(c) të këshillojë Komisionin në lidhje me çdo ndryshim të propozuar të kësaj Direktive, për çdo masë shtesë apo specifike që duhet marrë me qëllim mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njerëzve në lidhje me përpunimin e të dhënave personale dhe për çdo projekt akt komunitar që ndikon tek këto të drejta dhe liri;

(d) të japë një opinion mbi kodet e etikës të hartuara në nivel Komunitar.

2. Grupi i Punës, sa herë që konstaton se ndërmjet ligjeve apo praktikave të Shteteve Anëtare manifestohen divergjenca që mund të çenojnë mbrojtjen ekuivalente të personave në lidhje me përpunimin e të dhënave në Komunitet, informon Komisionin.

3. Grupi i Punës mundet, me nismën e tij, të bëjë rekomandime për çështje që kanë të bëjnë me mbrojtjen e personave në lidhje me përpunimin e të dhënave personale në Komunitet.

4. Opinionet dhe rekomandimet e Grupit të Punës i përcillen Komisionit dhe komitetit të përmendur në Nenin 31.

5. Komisioni informon Grupin e Punës për veprimet e ndërmarra prej tij si përgjigje e opinionëve dhe rekomandimeve të dhëna. Ai e bën këtë me anë të një raporti i cili i përcillet Parlamentit Europian dhe Këshillit. Raporti publikohet.

6. Grupi i Punës harton një raport vjetor në lidhje me gjendjen e mbrojtjes së individëve në lidhje me përpunimin e të dhënave në Komunitet dhe në vendet e treta, të cilin ia përcjell Komisionit, Parlamentit Europian dhe Këshillit. Raporti publikohet.

KAPITULLI VII

MASAT ZBATUESE KOMUNITARE

Neni 31

Komiteti

1. Komisioni ndihmohet nga një komitet i përbërë prej përfaqësuesve të Shteteve Anëtare dhe kryesohet nga përfaqësuesi i Komisionit.

2. Përfaqësuesi i Komisionit i paraqet komitetit një projekt të masave që do të miratohen. Komiteti e paraqet opinionin e tij për projektin brenda afatit kohor që përcaktohet nga kryetari në varësi të urgjencës së çështjes.

Opinionin formulohet nga shumica e parashikuar në Nenin 148 (2) të Traktatit. Votat e përfaqësuesve të Shteteve Anëtare brenda komitetit ponderohen në mënyrën e parashikuar në nenin e sipërpërmendur. Presidenti nuk merr pjesë në votim.

Komisioni miraton masa të cilat gjejnë zbatim menjëherë. Megjithatë, nëse këto masa nuk janë në përputhje me opinionin e komitetit, ato do t'i komunikohen Këshillit nga ana e Komisionit. Në këtë rast:

- Komisioni shtyn afatin e zbatimit të masave për të cilat ka vendosur, për një periudhë tre mujore që nga data e komunikimit,

- Këshilli me shumicë të cilësuar mund të marrë një vendim të ndryshëm brenda afatit të përcaktuar në pikën e parë.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 32

1. Shtetet Anëtare venë në zbatim dispozitat ligjore, rregulloret dhe dispozitat administrative të nevojshme për të vepruar në përputhje me këtë Direktivë, jo më vonë se fundi i një periudhe tre vjeçare që prej datës së miratimit të saj.

Kur Shtetet Anëtare miratojnë këto masa, ato u referohen kësaj Direktive ose shoqërohen me një referencë të tillë në aktin e publikimit zyrtar. Mënyrat e kryerjes së kësaj reference, përcaktohen nga Shtetet Anëtare.

2. Shtetet Anëtare sigurohen se përpunimet e nisura para datës së hyrjes në fuqi të dispozitave kombëtare të miratuara në përputhje me këtë Direktivë, do të jenë në përputhje me këto dispozita brenda tre viteve nga kjo datë.

Duke deroguar nga paragrafi paraardhës, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që përpunimi i të dhënave që tashmë mbahen në arkiva manuale në datën e hyrjes në fuqi të dispozitave kombëtare të miratuara në zbatim të kësaj Direktive, do të sillen në përputhje me Nenet 6, 7 dhe 8 të kësaj Direktive brenda 12 viteve nga Data e miratimit të kësaj direktive. Megjithatë, Shtetet Anëtare i japin subjektit të të dhënave të drejtën që të marrë, me kërkesën e tij dhe sidomos gjatë ushtrimit të së drejtës së tij për akses, korrigjimin, fshirjen ose bllokimin e të dhënave të cilat janë të paplota, të pasakta apo të ruajtura në një mënyrë që nuk është në përputhje me qëllimet e ligjshme të kontrolluesit.

3. Duke deroguar nga paragrafi 2, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë, me rezervën e garancive të përshtatshme, që të dhënat që mbahen vetëm për qëllime të kërkimeve historike, nuk duhet të sillen në përputhje me dispozitat e neneve 6, 7 dhe 8 të kësaj Direktive.

4. Shtetet Anëtare i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave të së drejtës së brendshme që ato miratojnë në fushën që rregullohet nga kjo Direktivë.

Neni 33

Komisioni i raporton periodikisht Këshillit dhe Parlamentit Europian, për herë të parë jo më vonë se tre vjet nga data e përmendur në nenin 32 paragrafi 1, një relacion mbi zbatimin e kësaj Direktive, të shoqëruar, nëse është e nevojshme nga propozime të përshtatshme për ndryshime. Raporti bëhet publik.

Komisioni shqyrton sidomos zbatimin e kësaj Direktive për përpunimin e të dhënave në formën e tingujve apo të dhënave në formë imazhesh që lidhen me individët dhe paraqet propozimet e nevojshme, duke mbajtur parasysh zhvillimet në teknologjinë e informacionit dhe në dritën e përparimit të shoqërisë së informacionit.

Neni 34

Kjo Direktivë u Adresohet Shteteve Anëtare.

Bërë në Luksemburg më 24 October 1995.

Për Parlamentin Europian

Presidenti

K. HAENSCH

Për Këshillin

Presidenti

L. ATIENZA SERNA